



Datë: 12.09.2025
Numër Protokolli: 6129/2025

A.nr.1240/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1240/2025, të datës 27.06.2025, të parashtruar nga ankuesja F.E kundër organit të punësimit: Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë, në çështjen juridike “Kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.1240/2025, të datës 27.06.2025, të parashtruar nga ankuesja, F.E.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, F.E(në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 27.06.2025, përmes postës elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit përfundimtar të datës 29.05.2025, për Grupi i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës, për pozitën e punës Inspektor i Tokës Bujqësore, të shpallur nga Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 01.07.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë, ndërsa, kjo e fundit, më datë 09.07.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.1240/2025, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë, më datë 21.03.2025, ka shpallë Konkursin publik me numër reference RN00017154, për Grupi i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës, për pozitën e punës Inspektor i Tokës Bujqësore, në Drejtoratin e Kontrollit, klasa e pozitës Profesional 1, për pesë (5) vende të lira pune, i hapur për aplikim nga data 22.03.2025 deri më datën 20.04.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezultojnë se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja, e cila ka kaluar fazën e verifikimit paraprak dhe se e njëjta i është nënshtruar fazës së vlerësimit profesional, ku në testin me shkrim ka arritë 42 pikë, si pikë të pamjaftueshme për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit, gjegjësisht intervistës me gojë.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë, më datë 29.05.2025, ka publikuar Listën përfundimtare të vlerësimit të kandidatëve për procedurën e kontestuar të pranimit, nga dhe rezultojnë se si kandidatë fitues janë shpallur: L.M me 98 pikë, N.N me 98 pikë, N.S me 96.8 pikë, E.S me 93.6 pikë dhe A.G me 92.2 pikë.

Pas publikimit të rezultateve përfundimtare të vlerësimit, të ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar rezultatin përfundimtar për kandidatët fitues, për pozitën përkatëse, mbi pretendimin ankimor se testimi me shkrim nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë nga Komisioni i Pranimit. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloj këtë proces rekrutimi në tërësi.

Bazuar në të dhënat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rezultojnë se kandidati Driton Sylejmani, si kandidat aplikues në procedurën e rekrutimit në procedurën e rekrutimit me reference RN00017154, për pozitën “Inspektor i Tokës Bujqësore” në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë si dhe çdo veprim tjetër që ka rrjedhë nga kjo procedurë e rekrutimit, kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së njëjtë, ndërsa, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin A.nr.1045/2025, të datës 08.08.2025, ka anuluar njoftimin për njoftimin për kandidatët fitues si dhe çdo veprim tjetër që ka rrjedhë nga kjo procedurë e rekrutimit.

Andaj, referuar gjendjes së fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.1240/2025, të datës 27.06.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimit për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.1045/2025, të datës 08.08.2025, rrjedhimisht, ka anuluar në tërësi procedurën e pranimit me numër reference RN00017154, si një qëllim i propozuar edhe nga ankuesja në petitumin e ankesës, atëherë, mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: “Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”. Kolegji vlerëson se objekti i ankesës A.nr.1240/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundojë procedimin administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.1240/2025, të datës 27.06.2025.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1240/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtese

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, F.E;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së